



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 32
27.10.2017

NR. VENDIMI 27
28.10.2017

VENDIM

“Per zgjatjen e aftatit te sekuestrimit te pasurise”

Gjykata e Shkalles se Pare
per Krime te Renda Tirane e perbere prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Evloinda Adili**, sot ne daten **28/10/2017**, ora **11:00 ne Tirane**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen me **nr. 32 rregjistri** qe i perket:

Kerkues: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, **perfaqesuar ne gjykim nga prokurorja Elizabeta Imeraj.**

KUNDER

Shtetasve P. Ç. , V. Ç. dhe G. G.

Me objekt: Zgjatjen e afatit te sekuestrimit

Baza ligjore: Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

Ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses te zhvilluar ne prani te prokurores qe kerkoi: pranimin e kerkeses, kjo gjykate pasi degjoi kerkimet dhe shqyrtoi

aktet e paraqitura:

VEREN se :

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, ka paraqitur para kesaj gjykate nje kerkese per zgjatjen e afatit te sekuestrimit te vendosur nga kjo gjykate me vendimin e saj nr. 14, date 24/04/2017 per pasurine në emër të shtetasve **P. Ç. , V. Ç. dhe G. G. , konkretisht:**

- Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në llogarinë e shtetasit **P. V. Ç.** pranë bankës Raiffeisen me nr.llogarie XXXXXXXXXXXX me balancë 640.000 euro.
- Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në llogarinë bankare pranë Tirana Bank në emër të shtetasës **V. Th. Ç.** me nr.XXXXXXX e më konkretisht: depozitë me afat me nr.XXXX-XXXXXX-XXX lek me gjendje 600,000.00 lek, depozitë me afat me nr.XXX-XXXXXX-XXX lek me gjendje 491,000.000 lek.
- Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në llogarinë e klientes G. Z. G. pranë Tirana Bank në shumën 225,845 euro të transferuara nga llogaria e shtetasës V. Ç. më datë 27.02.2017 me përshkrimin “kalim fondi” dhe te gjitha shtesat ne keto llogari deri ne momentin e sekuestrimit te tyre.
- Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet znj. B. I. e cila është administratore e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.
- Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Tiranë.

Per shkak se perundon afati 6 mujor i kohezgjatjes se kesaj sekuestroje, Prokuroria Per Krime Te Renda kerkon nje zgjatje te afatit te saj.

Nje kerkese te tille, prokurorja e ben ne mbeshtetje te nenit **12/3 te Ligji nr. 10192 date 03/12/2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise” dhe pretendimit se verifikimet e ketij rasti sekuestrimi jane komplekse.

Kjo gjykate e çmon si te bazuar pretendimin e kerkueses, Prokurorise per Krime te Renda te cilin e pranon duke zgjatur afatin e zbatimit te mases se sekuestrimit te vendosur nga kjo gjykate me vendimin

nr. 14 date 24/04/2017 per nje periudhe tre mujore mbi keto argumenta:

“Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka regjistruar procedimin pasuror nr.02, më datë 21/04/2017 në ngarkim të shtetasve P. Ç. e V. Ç. , mbi bazën e informacionit dhe akteve bashkëlidhur të përcjella nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga te dhenat e këtyre akteve ka rezultuar se procedimi penal nr.513 është regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë më datë 29/03/2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale, në ngarkim të shtetasit P. Ç. , mbi bazën e akteve të referimit të veprës penale të dërguara nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, me shkresën nr.46/195 si edhe disa verifikime të kryera.

Me kerkese te Prokurorise, kjo Gjykate si Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda me vendimin nr.14, date 24/04/2017 ka vendosur masen e sekuestros mbi vlerat monetare ne llogarite bankare te ne emer te shtetaseve **P. Ç. , V. Ç. dhe G. G. .**

Ky vendim eshte zbatuar ne daten 28/04/2017(e dhene perftuar nga shkresa nr.425 Prot, date 02/05/2017 e Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane dhe procesverbalit te ekzekutimit qe shoqeron kete akt njoftimi.)

Mbi parashikimin e nenit 12/2 te ligjit te **Ligji nr. 10192 date 03/12/2009** (ligji i zbatueshem ne kete sekuestro per shkak te kohes se vendosjes se saj) eshte i vlefshem per nje periudhe 6 mujore, kohe pas te ciles eshte zgjatur me vendimet e kesaj gjykate fuqia e sekuestros mbi pasurite vlera monetare.

Prokuroria Per Krime te Renda pretendon ne kete kerkim se verifikimet e ketij rasti sekuestrimi jane komplekse.

Kjo gjykate e çmon te perligjur pretendimin e kerkueses dhe kerkesen per zgjatje te afatit te sekuestros ne perputhje me parashikimin e nenit 12/3 te Ligjit parandalues duke e konsideruar kompleks kete verifikim te hetimit pasuror per shtetasit **P. Ç. , V. Ç. dhe G. G. ,** mbi pretendimet e tyre se te ardhurat vijnë nga puna ne emigracion e tyre ne Greqi dhe Gjermani, duke vleresuar mbi te gjitha se verifikimi kerkon bashkepunim juridik te ndersjellte ndershtetror, Shqiperi-Greqi, Shqiperi- Gjermani dhe autoriteteve kompetente te drejtesise, nepermjet leter-porosise (procedura e se ciles zgjat ne

kohe).

Mbi kete baze me kerkese te kerkueses, kjo gjykate ne zbatim te nenit 12/3 **Ligjit nr. 10192 date 03/12/2009** (ligji i zbatuar per shkak te kohes kur eshte vendosur kjo sekuestro) vendos zgjatjen e afatit te zbatimit te sekuestros se caktuar prej saj me vendimin nr. 14 date 24/04/2017 per nje periudhe tre mujore duke filluar ky afat nga data 15/10/2017.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper, ne baze te nenit 12 ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”, kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe ne mbeshtetje te provave te shqyrtuara ne kete gjykim:

V E N D O S I:

Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

Zgjatjen per nje periudhe tre mujore te afatit te zbatimit te mases se sekuestrimit te vendosur me vendimin Nr. 14 date 24/04/2017 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane ndaj Pasurise ne emer te Sekuestrimin e pasurive ne emer te shtetaseve **P. Ç. , V. Ç. dhe G. G. , konkretisht:**

Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në llogarinë e shtetasit **P. V. Ç.** pranë bankës Raiffeisen me nr.llogarie XXXXXXXX me balancë 640.000 euro.

Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në llogarinë bankare pranë Tirana Bank në emër të shtetases **V. Th. Ç.** me nr.XXXXXXXX e më konkretisht: depozitë me afat me nr.XXXX-XXXXXXXX-XXX lek me gjendje 600,000.00 lek, depozitë me afat me nr.XXXX-XXXXXXXX-XXX lek me gjendje 491,000.000 lek.

Sekuestrimin e vlerave monetare që ndodhen në llogarinë e klientes G. Z. G. pranë Tirana Bank në shumën 225,845 euro të transferuara nga llogaria e shtetases V. Ç. më datë 27.02.2017 me përshkrimin “kalim fondi” dhe te gjitha shtesat ne keto llogari deri ne momentin e sekuestrimit te tyre.

Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te njoftoje menjehere per

kete vendim administaroren e pasurise znj. Burbuqe Islami, ne Agjencine e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohet Zyra e Permbarimit Tirane.

Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te dergoje menjehere kopje te ketij vendimi ne institucionet e mesiperme si dhe per njoftimin e zoteruesve te pasurise ne adresat e tyre.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

U shpall sot ne Tirane, me date 28/10/2017

Sekretare

Evloinda ADILI

Gjyqtare

Iliriana OLLDASHI

